



Pozicion Vakant

Social Media Manager

Ahead Creative Agency, mbësht klientët e saj në baza ditore duke i ndihmuar ata të gjenerojnë të ardhura, duke krijuar strategji efektive marketingut. Ne i kthejmë idetë tona krijuese në blloqe ndërtimi të suksesit për klientët tanë, duke krijuar kështu një lidhje që i bën historitë tona kolektive edhe më frymëzuese.

Pozicioni i Punës: Social Media Manager

Kontrata e Punës: Pa Afat

Gjuha: Italisht

Vendodhja: Tiranë

Qëllimi i Pozicionit: Krijimi, përmirësimi dhe komunikimi i imazhit & identitetit të klientit për t'ja përcjellë konsumatorit/klientit.

Përgjegjësitë dhe Detyrat Kryesore:

- Zbaton strategjinë dhe planet e propozuara si nga pikëpamja kreative ashtu edhe nga ajo operationale mbeshtetur në treguesit që i bëjnë ato të matshme.
- Garanton cilësi dhe profesionalizëm maksimal të produktit & shërbimit të ofruar.
- Garanton anën drejtshkrimore të materialeve.
- Është përgjegjës/e për përmbushjen e objektivave individuale si pjesë e atyre të Agjencisë.
- Garanton ruajtjen dhe arshivimin e duhur të dokumentacionit sipas listës së përcaktuar.
- Raporton në formatet dhe afatet e përcaktuara.
- Përcakton dhe përmirëson treguesit më të rëndësishëm të performancës të mediave sociale dhe sigurohet për optimizimin e tyre.
- Hulumtimi dhe analizimi i industrisë dhe trendeve më të fundit të saj.
- Ekzekuton fushatat promociionale dhe ndjek ecurinë e tyre në kohë reale për të garantuar rezultatin maksimal me buxhete optimale.
- Përthith informacion dhe njohuri për zhvillimet dhe avancimet e shërbimeve të fushës dhe ndryshimet e pritshme të kërkesave të Klientëve. Azhurnohet me zhvillimet më të fundit të teknologjisë sidomos në aspektin komunikim, marketing dhe publicitet.
- Punëdhënësi mund t'i caktojë punëmarrësit edhe përgjegjësi e detyra të tjera bazuar në nevojat e kompanisë.

Aftësitë, Përvoja dhe Kualifikimet:

- Bachelor në Administrim Biznes ose Marketing.
- Njohje e shkëlqyer e praktikave më të mira për reklamimin në Facebook, LinkedIn, Instagram, TikTok, dhe rrjete të tjera sociale.
- Njohja e Meta Business Suite dhe ADS Manager.
- Njohje e programeve të editimit si Canva.
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, shkrimi, redaktimi dhe prezantimi
- Aftësi për të punuar në mënyrë autonome dhe me ekip
- Njohuri të forta të marketingut në mediat sociale.
- Aftësi krijuese
- Aftësi të mendimit strategjik
- Aftësi hulumtuese
- Njohuri shumë të mira të gjuhës Italiane dhe Angleze

Nëse keni kualifikimet e listuara më sipër, lutem dërgoni CV-në tuaj duke specifikuar titullin e punës në: info@ahead.al

Data e fundit e aplikimit do të jetë data 15/07/2023

"Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit nr.9887 të vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale"